

AKADEMIA LOKALE E DIALOGUT E OSBE-SË PËR GRATË E REJA

27 qershor - 1 korrik 2022, Hotel Magra¹, Bogë, Pejë²

THIRRJE PËR APLIKIM

Rreth Akademisë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja

Akademia Lokale e Dialogut e OSBE-së për Gratë e Reja shërben si platformë për gratë e reja që të kapërcejnë pengesat në komunikim, të thyejnë stereotipet e të vendosin një bazament për dialog përmes aktiviteteve të të nxënës, trajnimit e mentorimit nga bashkëmoshataret. Ajo synon të rrisë komunikimin në rrjet ndërmjet komuniteteve duke u fokusuar në çështje të përbashkëta shqetësuese, në veçanti të atyre që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Kriteret për aplikim

Thirrja për aplikim është e hapur për gra të reja të moshës 16-19 vjeç³ nga Kosova të cilat janë të interesuara për të marrë pjesë në procese të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokimit. Njohja e gjuhës angleze nuk është e obligueshme.

Struktura dhe temat

Akademia Lokale e Dialogut e OSBE-së për Gra të Reja parasheh trajnim pesë ditorë me aktivitete ekip-ndërtuese dhe trajnim nga bashkëmoshatarë, trajnim interaktiv për udhëheqje dhe trajnim për shkathtësi praktike.

Nëpërmjet moduleve të mësimi interaktiv, pjesëmarrëset do ta kenë mundësi që t'i zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e fuqizimit të gruas, udhëheqjes dhe ndërtimit të urave të komunikimit për një shoqëri të qëndrueshme.

Temat që do të shtjellohen janë:

- Masat për ngritjen e mirëbesimit;
- Fuqizimi dhe pjesëmarrja e grave në procese publike dhe të politikëbërjes;
- Dialogu dhe zgjidhja e konfliktit;
- Shkathtësi praktike si të shkruani letër motivuese dhe CV.

Aranzhimet

Të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes në Akademinë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja do të mbulohen nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), përfshirë transportin, ushqimin, pijet freskuese, akomodimin si dhe koston e modulit të kursit.

Aplikimi

Për informata shtesë ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe profilet në mediat sociale.

1. Në qoftë se situata epidemiologjike lejon tubime fizike në kohën e paraparë për mbajtjen e aktivitetit.

2. Aktiviteti do të organizohet në përputhje me vendimet e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë në kohën e paraparë për mbajtjen e aktivitetit.

3. Të miturave nën moshën 18 do t'u duhet të dorëzojnë pëlqimin e nënshkruar nga të dy prindërit (nëse është e aplikueshme). Formulari përkatës ndodhet në paketën e aplikimit.

A JENI PËR? SHUMË MIRË, APLIKONI TANI!

Ju lutemi ta dërgoni aplikacionin deri më 24 prill 2022 (23:59 h) në
localIDA-OMiK@osce.org

#LDA22
#OSCEIDA

